

Ti, e beson atë çfarë dëgjon dhe shikon?!

Klodiana Kapo

Në mars të vitit 2020 i gjithë vendi u izolua. Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 po përhapej me shpejtësi. Numri i personave të vdekur në botë rritej dhe të panjohurat mbi të sollën frikë dhe panik. Në këto ditë të pazakonta, Kryeministri Shqiptar Edi Rama, bën publike një video ku tregohet se si policia spanjolle dhunonte qytetarët të cilët kishin shkelur orarin e kufizimit. Pak minuta më pas, Faktoje, organizata që ofron shërbimin e verifikimit të fakteve në Shqipëri dhe që është pjesë e International Fact Checking Network (IFCN), verifikon të dhënat e filmimit, dhe deklaron se pamjet e publikuara nga kryeministri Edi Rama i përkisnin një proteste të ndodhur në qytetin Hirak, në Algjeri, më 7 mars 2020. Kryeministri Edi Rama, pranon se ai kishte rënë pre e [dezinformimit](#)¹.

Por pse ka rëndësi verifikimi i deklaratave, premtimeve apo filmimeve dhe fotove që përhapen me shpejtësi kudo? Bota e [internetit](#)² ka përpirë çdo qytetar të rruzullit tokësor. Në epokën e pandemisë, informimi u përqendrua kryesisht në botën digjitale, çka shkaktoi edhe infodeminë. Mungesa e të dhënave të sakta nga bota e mjekësisë i hapi rrugë prodhimit të informacioneve të pavërteta dhe të dëmshme për jetën e njerëzve. Frika dhe paniku, sollën shpërndarje të menjëhershme të lajmeve të ndryshme që qarkullonin në rrjetet digjitale.

Po përse faktet kanë rëndësi, edhe në një botë pa pandemi?

Faktoje, një organizatë e pavarur dhe transparente ofron një shërbim të ri të gazetarisë në vend. Gjatë këtyre dy viteve ka verifikuar mbi 300 deklaratat dhe premtime ku më shumë se 60% e tyre rezultojnë të pavërteta apo gjysmë të vërteta.

Pak kohë më parë kreu i opozitës, Lulzim Basha deklaroi se pagat e mësuesve gjatë dy mandateve të Partisë Socialiste nuk janë rritur.

Faktoje bëri verifikimin e kësaj deklarate duke iu përmbajtur metodologjisë së saj, dhe në përfundim rezultoi se kjo deklaratë ishte [e pavërtetë](#)³.

Pse ka rëndësi verifikimi i fakteve për opinionin publik? Ti ke mundësi të dëgjosh fakte dhe jo opinione, të informohesh dhe të ndërtosh mendimin tënd mbi të dhëna dhe evidenca të sakta. Nëse Faktoje nuk do të kryente verifikimin e kësaj deklarate, qytetarët do të besonin këtë deklaratë, disa nuk do ta besonin, një pjesë do të qëndronte indiferente ose skeptike.

Prej më shumë së 15 vjetësh, në Shqipëri, informacioni që vjen nga të gjitha partitë politike është i kontrolluar si në zë dhe figurë. Një trend që u importua nga “jashtë” e që klasa jonë politike e përqafoi dhe e përsosi ethshëm duke mos u kursyer në investime dhe rekrutime.

Kasetat e prodhuara, apo materialet e sjella me *WeTransfer* u pranuan me hezitim nga mediat e mëdha shumë vite më parë. Sot është thjesht një fakt i kryer.

Mediat e shkruara dhe vizive u kthyen në promotorë të këtyre mesazheve që u përgatitën me kujdes në zyrat e fryra të shtypit, për të shpërndarë mesazhe të qëllimta. Në rast se do të shohim disa media të ndryshme do të vihet lehtësisht re se mesazhet politike janë të njëjta.

¹[Si mund ta shmangte kryeministri Rama dezinformimin dhe përhapjen e panikut?](#)

² [Birn Albania publikon raportin mbi Qeverisjen e Internetit](#)

³ [Basha: Në 7 vite nuk u rritën pagat e arsimtarëve](#)

Një sy vëzhgues do të shohë se këto mesazhe transmetohen në mediumet televizive përmes një grafiku të përcaktuar, në forma inovative, duke vënë personazhet e politikës “në aksion” e madje duke i marrë rolin e *stand up*-it gazetarit. I gjithë ky investim në kapacitete njerëzore dhe me një faturë të lartë financiare për xhepin e varfër të qytetarëve ka nxjerrë tërësisht jashtë loje gazetarin e pavarur.

Shërbimi i verifikimit të fakteve, ky trend i ri i gazetarisë moderne në vend, që në botë funksionon prej dekadash, mbërriti në Shqipëri si një formë e domosdoshme për të kryer transparencën, por edhe për të nxitur llogaridhënien.

Në gusht të vitit 2019, Fakteje kërkon të bëhen publike shpenzimet e krerëve të ministrive në udhëtimet jashtë vendit. Një praktikë kjo që ishte zbatuar më herët edhe nga kolegët tanë në Kosovë. Faturat e para të bëra publikë ishin ato të Ministrisë së Drejtësisë, ku u vu re se kostot e hotelit për një natë shkonin deri në 700 euro. Një standard që qeveria shqiptare e ka të zyrtarizuar që prej vitit 2011, kur Ministër i Financave ishte zoti Ridvan Bode. Mediat u morën më këtë çështje për disa ditë, dhe ministria tha se do të niste një proces verifikimi, gjetjet e të cilave ende s'janë bërë publike. Ministrinë e tjera refuzuan të bëjnë publike këto shpenzime, ndaj Fakteje i drejtohet gjykatës në mënyrë që ajo të zbatojë Ligjin për të Drejtën e Informimit. Specifikisht, 11 institucione u paditën nga Fakteje me të njëjtën kërkesë. Gjykata Administrative jep të drejtë për 8 prej tyre, 3 janë ende në proces gjyqësor (deri në datën e botimit të këtij shkrimi).

Presidenca [refuzon zbatimin e vendimit](#)⁴ duke akuzuar për shkelje të ligjit përmbaruesin e çështjes. Kundrejt këtij veprimi, Dhoma Kombëtare e Përmbarimit, kërkoi vënien në lëvizje të Gjykatës së Lartë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor për ‘orientimin’ e gjyqtarëve për çështjet administrative. Ekspertët ligjorë e konsiderojnë këtë një presion të hapur ndaj gjyqtarëve që vendosin në favor të transparencës dhe llogaridhënies. Gjatë këtij rrugëtimi, që ka në themel transparencën, Fakteje është shënjestruar nga intimidimet dhe presionet jo direkte.

Pas 30 vjetësh [tranzicion](#)⁵, Shqipëria, ky vend i vogël i Ballkanit Perëndimor, po tregon se ka shumë nevojë për transparencë, fakte të vërteta dhe informim të drejtë.

⁴ [Presidenca refuzon të japë faturat, presion kundër përmbaruesit dhe gjykatës që i dha të drejtë Fakteje.](#)

⁵ [Vendet në tranzicion 2020](#)